



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK**

---

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Nr.1080/1Prot.

Shkodër, më 29.01.2019

**Lënda:** Jepet informacioni i kërkuar

**Rruga:** \_\_\_\_\_

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 37, datë 22. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 1080, datë 23. 01. 2019 dhe kërkesës suaj Nr. 35, datë 22. 01. 2019 regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 1082, datë 23. 01. 2019 në të cilat, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Bashkia e Shkodrës, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe Qendrave Komunitare “Për Familjen”, ofron shërbime për individët dhe familjet, vulnerabël dhe në vështirësi socio-ekonomike. Pjesë e shërbimeve është zbatimi i vendimeve të gjykatës për urdhër të menjëhershëm mbrojtje apo urdhër mbrojtje dhe monitorimi i urdhërave të mbrojtjes .

Sa i përket masave të Bashkisë Shkodër për zbatimin e vendimit gjyqësor, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve, ju bëjmë me dije se deri tani nuk kemi patur raste të tilla. Çdo vendim dhe çdo rast do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në shërbim të individëve në nevojë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**

---